



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 09 Janar 2013
Nr. ref.: RK337/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI74/12

Parashtrues

Agim Stublla

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës
Supreme të Republikës së Kosovës, PN. nr. 410/2012, të datës 5 qershor 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Agim Stublla, nga fshati Lluzhan i komunës së Podujevës.

Vendimet e kontestuara

2. Vendime të autoritetit publik, me të cilat pretendohen shkeljet e garantuara me Kushtetutë, janë: Aktvendimi i Gjykatës Supreme, PN. nr. 410/2012, i datës 5 qershor 2012; Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut, PN. nr. 65/2012, i datës 3 prill 2012; Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Lipjan, KP. Nr. 30/2011, i datës 8 dhjetor 2011; dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Lipjan, P. nr. 129/2009, i datës 13 shkurt 2010.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së lëndës së parashtruar, më 7 gusht 2012, në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, PN. nr. 410/2012, të 5 qershorit 2012; Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut, PN. nr. 65/2012, të 3 prillit 2012; Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Lipjan, KP. Nr. 30/2011, të 8 dhjetorit 2011; dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Lipjan, P. nr. 129/2009, të datës 13 shkurt 2010, me ç'rast, parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata Kushtetuese të anulojë vendimet e gjykatave të rregullta dhe të bëjë rishikim të procesit gjyqësor, sipas Nenit 442 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Shkeljet e pretenduara të të drejtave të garantuara me Kushtetutë

4. Parashtruesi i kërkesës, në kërkesën e tij, nuk ka potencuar shkelje specifike të të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, i 15 janarit 2010 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe rregulli 29 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

6. Gjykata ka evidencuar që, parashtruesi i kërkesës, edhe më herët, më 13 shtator 2010, kishte paraqitur kërkesë në Gjykatë me objekt të njëjtë shqyrtimi, e cila ka qenë e regjistruar në regjistrin përkatës me Nr. KI84/10.
7. Gjykata, në seancën e mbajtur më 23 shkurt 2011, me shumicë votash e kishte refuzuar si të papranueshme kërkesën KI84/10, në të cilën parashtrues ka qenë z. Stublla.
8. Më 7 gusht 2012, parashtruesi i kërkesës dorëzoi sërish një kërkesë të re në Gjykatën Kushtetuese.
9. Më 4 shtator 2012, me vendimin GJ.R. 74/12, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi si Gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Almiro Rodrigues (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani (anëtarë të Kolegjit).
10. Më 2 tetor 2012, Gjykata Kushtetuese njoftoi Gjykatën e Qarkut në Prishtinë dhe Gjykatën Supreme përkitazi me regjistrimin e kërkesës.
11. Më 4 tetor 2012, Gjykata Supreme është përgjigjur në kërkesën e Gjykatës nëse kishte ndonjë koment për këtë çështje, duke deklaruar se të gjitha argumentet përkitazi me çështjen në fjalë janë dhënë në arsyetimin e vendimit.

Përmbledhja e fakteve

12. Parashtruesi i kërkesës ka shërbyer në Shërbimin Policor të Kosovës, si zyrtar policor, që nga data 12 mars 2001.
13. Në mars të vitit 2009, parashtruesi i kërkesës ishte akuzuar për kryerjen e veprës penale vjedhje dhe, më 13 shkurt 2010, nga Gjykata Komunale në Lipjan, me vendimin P. nr. 129/2011, ishte dënuar me tre muaj burgim, të cilin dënim nuk ka për ta mbajtur nëse në afat prej një viti nuk kryen vepër tjetër penale.
14. Të gjitha faktet e parashtruara nga z. Stublla në kërkesën e re, për sa i përket Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Lipjan, P. nr. 129/2009, dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PKL nr. 69/2010, të 6 gushtit 2010, janë krejtësisht të njëjta, sikur në kërkesën e parë të parashtruar në këtë Gjykatë, më 13 shtator 2010.
15. Parashtruesi i kërkesës, megjithatë, në kërkesën e re, si fakte të reja e të pashqyrtuara nga Gjykata Kushtetuese, kishte prezantuar: Aktvendimin e Gjykatës Supreme, PN. nr. 410/2012, e datës 5 qershor 2012; Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut, PN. nr. 65/2012, e datës 3 prill 2012; dhe Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Lipjan, KP. Nr. 30/2011, e datës 8 dhjetor 2011.
16. Më 8 dhjetor 2011, Gjykata Komunale në Lipjan nxori Aktvendimin KP. Nr. 30/2011, duke vepruar në bazë të kërkesës për rishikimin e procedurës penale, me ç'rast hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se kërkesa është e pabazuar, pasi që parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë provë të re që do ta bënte kërkesën e bazuar dhe se vetëm kishte përsëritur pretendimet e shqyrtuara më parë nga kjo gjykatë.
17. Më 3 prill 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë nxori Aktvendimin PN. nr. 65/2012, duke vepruar në bazë të ankesës së parashtruesit të kërkesës, me ç'rast hodhi poshtë ankesën, me arsyetimin se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 442 të KPPK-së për rishikimin e procedurës penale, andaj e refuzoi ankesën si të pabazuar, dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Lipjan, KP. Nr. 30/2011, e datës 8 dhjetor 2011.
18. Më 5 qershor 2012, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vepruar në bazë të ankesës së parashtruesit të kërkesës, nxori Aktvendimin Pn. nr. 410/2012, ku hodhi poshtë ankesën si të palejuar, me arsyetimin që Aktvendimi i Gjykatës së shkallës së dytë është i formës së prerë dhe ankesa, si mjet i rregullt, nuk është e lejuar.
19. Përfundimisht, i pakënaqur me vendimet e lartcekura, më 8 gusht 2012, parashtruesi i kërkesës i ishte drejtuar përsëri Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Pretendimet e parashtruesit

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat njerëzore të garantuara me Kushtetutë, duke mos i specifikuar se cilat të drejta pretendon se i janë shkelur.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

21. Për të qenë në gjendje për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të vlerësojë paraprakisht nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë, të cilat përcaktohen në Kushtetutë.

22. Përkitazi me këtë, Gjykata merr parasysh rregullin 36, par. 1, pika c, dhe par. 3, pika e, e Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, ku përcaktohet:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

c) Kërkesa është qartazi e bazuar”

dhe

“(3) Një kërkesë mund të konsiderohet e papranueshme edhe në rastet vijuese kur:

e) Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa e re nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri”.

23. Në këtë drejtim, sa i përket çështjeve të ngritura nga parashtruesi, e që kanë të bëjnë me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Lipjan, p. Nr. 129/2009, dhe me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, PKL nr. 69/2010, e 6 gushtit 2010, Gjykata konstaton se kjo çështje është tashmë e gjykuar me vendimin KI84/10 dhe gjykata nuk do ta rivlerësojë kushtetutshmërinë e këtyre akteve juridike.
24. Për këtë, edhe GJEDNJ (*Shih, X kundër Gjermanisë, aplikacioni nr. 1860/63; Duclos kundër Francës, aplikacioni nr. 20940/92, 17.12.1996*) ka theksuar që kërkesa do të shpallet e papranueshme në rastet kur parashtruesi do të përsërisë ankesat që kishte formuluar në një kërkesë të mëparshme.
25. Megjithatë, duke marrë parasysh se parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e fakteve të reja, ka paraqitur Aktvendimin e Gjykatës Supreme, PN. nr. 410/2012, e datës 5 qershor 2012; Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut, PN. nr. 65/2012, e datës 3 prill 2012; dhe Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Lipjan, KP. Nr. 30/2011, e datës 8 dhjetor 2011, të cilat kanë të bëjnë me procedurën përkitazi me kërkesën për përsëritjen e procedurës, e cila është e ndryshme nga procedura për mbrojtjen e ligjshmërisë që ishte objekt i shqyrtimit të kërkesës së parë, për këtë arsye, Gjykata, për këtë pjesë të kërkesës, mbështetur edhe në praktikën e GJEDNJ-së *“kur kërkuesi paraqet fakte të reja, kërkesa nuk do të jetë thellësisht e njëjta me kërkesën pararendëse”*, kërkesën e re, sa i përket fakteve të reja, do ta marrë në shqyrtim (*Shih, Chappex kundër Zvicrës, aplikacioni nr. 20338/92, i datës 12.10.1994; dhe Patera kundër Çekisë, aplikacioni nr. 25326/03, i datës 10.01.2006*).
26. Bazuar në këtë, Gjykata Kushtetuese, duke bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, PN. nr. 410/2012, të 5 qershorit 2012; Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut, PN. nr. 65/2012, të 3 prillit 2012; dhe Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Lipjan, KP. Nr. 30/2011, të 8 dhjetorit 2011, nuk gjen asnjë fakt të jenë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë. Në fakt, parashtruesi i kërkesës, përpos shprehjes së pakënaqësisë për aktvendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta, nuk ka argumentuar në mënyrë bindëse se pse gjykimi “nuk ka qenë i drejtë dhe i paanshëm”, se në cilën mënyrë ai ka qenë i trajtuar si i pabarabartë, apo cila fazë e procedurës ka qenë kundërkushtetuese.
27. Në nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], pika 3, të Kushtetutës është paraparë qartazi: “Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit”, dhe, në nenin 103 [Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave], pika 2, të Kushtetutës, gjithashtu është përcaktuar qartazi: “Gjykata Supreme e Kosovës është autoriteti më i lartë gjyqësor”.

28. Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e faktit dhe, me këtë rast, dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i saj është vetëm të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt”, (*Shih, mutatis mutandis, i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65*).
29. Fakti se parashtruesit nuk pajtohen me rezultatin e rastit, nuk mund t’u shërbejë atyre si e drejtë të ngrënë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (*Shih, mutatis mutandis aktgjykim ECHR Appl. No. 5503/02, Meztur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykim i 26 korrikut 2005*).
30. Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese nuk gjen fakte se gjykatat e rregullta nuk kanë “gjykuar drejt dhe paanshëm”, duke sjellë vendime që mund t’i kenë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë.
31. Parashtruesi i ankesës nuk ka “argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”, andaj Gjykata gjen se, në përputhje me rregullin 36, paragrafi 2, pika (c) dhe (d), duhet të refuzohet kërkesa si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 36.2 pika (c) dhe (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 21 nëntor 2012, njëzëri:

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t’u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Artta Rama-Hajrizi



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani